



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova**  
**Republic of Kosovo**



**Komuna e Kaçanikut**  
**Opština Kačanik**  
**Municipal Kačanik**

**01Nr. 060/01-5006/25**  
**Kaçanik, 05.03.2025**

### **PROCESVERBAL**

Nga mbledhja e II (dytë) Solemne e Kuvendit të Komunës për vitin 2025, mbajtur me 05 Mars 2025. Mbledhja u mbajt në sallën e kuvendit të komunës, në katin e tretë, në ditën e mërkurë, me fillim pune në ora 10:00.

Pjesëmarrës të kësaj mbledhje nga KK ishin 9anëtarë, 6 nga PDK (Kemajl Murseli, Lirije Dema, Edon Baftiu, Rustem Zenuni, Fatmir Bunjaku, Bashkim Krasniqi), 3 nga LDK((Ardita Rrahmani, Betim Shala, Besnik Salihu). Në mbledhje munguan: 6 anëtarë nga PDK (Kadri Krivenjeva, Florina Lika-Vishi, Lejla Muhaxheri-Çaka, Brahim Imishti, Selajdin Troni, Hamide Luma), 8 anëtarët nga LVV (Agim Mani, Kadrije Lika-Troni, Bashkim Luma, Arta Avdiu, Burim Shehu, Naim Beça, Raif Kasa, Ernesta Krasniqi) 1 anëtar nga LDK- Arlinda Rakoci-Raka, 2 anëtarët nga AAK( Edona Luzha, Ekrem Livoreka), anëtari nga NISMA-Agim Çaka.

Nga Ekzekutivi i Komunës ishin: Kryetari i Komunës Besim Ilazi, drejtorët e drejtorive: Dardana Tafili-Dauti, Qamil Stagova, Sali Malsiu, Pranvera Loku-Zharku, Ramadush Osmani), ndërkaq nga zyrtarët e komunës në kuadër të detyrave të punës: Bejtulla Dalloshi, Fatlume Guri-Selimi, Maviye Murseli, Makfire Malsiu, ndërkaq pati edhe zyrtarë tjerë komunal.

Nga shoqëria civile pati pjesëmarrës nga OJQ-të e dala e UÇK-së dhe qytetarë tjerë. Mbledhja mbahet për nder të datave të shënuara 5, 6 dhe 7 Mars “Epopeja e UÇK”, në përkujtim të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem Jasharit dhe rënies heroike të Familjes Jashari.

Mbledhjen e Kryesoj, Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit,  
Procesmbajtës: Makfire Malsiu, Zyrtare lartë për punë të KK.

Mbledhjen Solemne e hapi Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli. Të nderuar, jemi mbledhur sot sërish brenda pak ditëve për të dytën herë, pas asaj mbledhje që shënuam Shpalljen e Pavarësisë së Kosovës sot në këtë mbledhje solemne, për të shënuar dhe kujtuar një nga ngjarjet me historike të luftës tonë të lavdishme, një nga sakrificat më sublime, luftën heroike të kryekomandantit të UÇK-së Adem Jashari dhe familjes së tij, e njohur tashmë si Epopeja e 5,6 dhe 7 marsit.

**Andaj, fillimisht për të nderuar këtë luftë dhe sakrificë të familjes Jashari, ju ftoj për një minutë heshtje!**

Për këtë mbledhje solemne, të datës 5 mars 2025, prezantoj agjendën:

#### **Agjenda e mbledhjes**

1. Fjala e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Kemal Murseli;
2. Fjalimi i Kryetarit të Komunës, Besim Ilazi;
3. Fjalimi i përfaqësuesve të grupeve parlamentare të Kuvendit të Komunës; dhe
4. Fjalimi i përfaqësuesit të shoqatave të dala nga lufta e Ushtria Çlirimtare e Kosovës-UÇK-së.

Në vazhdim, në përkujtim të ngjarjeve të shënuara, Kryesuesi i Kuvendit vazhdoj me fjalën e tij, pastaj fjalën e morën sipas Agjendës:

#### **1. Fjala e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Kemal Murseli**

Të nderuar,

Si çdo herë, veçanërisht, sot është momenti i veçantë ta shprehim vlerësimin, mirënjohjen, nderimin dhe respektimin me përkulje të thellë për familjen heroike Jashari, për të gjithë heronjtë, dëshmorët e martirët e lirisë.

Me luftën dhe rënien e kryekomandantit dhe familjes së tij, UÇK-ja u rrit në përmasa gjithëkombëtare dhe diplomacia botërore u vu në anën e luftës së drejtë të shqiptarëve. Me të drejtë, në analet e historisë moderne botërore, Ushtria Çlirimtare e Kosovës vlerësohet si projekti më i suksesshëm politiko -ushtarak.

Sot ne çdoherë kur marrim vendime të mëdha, nderojmë dhe përkulemi para varreve të tyre në Prekaz, në vendin e sakrificës mbarëkombëtare.

Në këto ditë, ne si asnjëherë me parë, e ndjejmë frymëmarrjen e lirë dhe e kujtojmë sesa e rëndësishme ishte për ne lufta çlirimtare, sesa të rëndësishëm ishin për ne ata djem e trima që morën armët dhe nuk pranuan peshën e rëndë të robërisë!

Sërish vjen marsi', nuk është vetëm një refren kënge, por moto e luftës tonë për liri dhe pavarësi që identifikohem me krye personazhin e luftës tonë, Adem Jashari dhe familjes së tij. Me 5,5 dhe 7 mars, Adem, Hamza treguan heroizëm dhe sakrificë të pashoq, duke mbrojtur prapun e shtëpisë së tyre, e pragu i shtëpisë së tyre simbolizonte vet Kosovën. Epopeja e UÇK-së, përcakton fatin tonë si popull dhe shtet. Adem Jashari ishte vizionar, ndërkaq guximi i tij nuk njihet kufi. , u sakrifikuan për lirinë tonë. Kosova është atdheu ynë që meriton çdo ditë përkushtimin tonë të palëkundur.

Pas rënies së kryekomandantit legjendar Adem Jashari, me mijëra djem dhe vajza rrokën armët për të vazhduar luftën deri në çlirimin e vendit, luftë kjo që mori vëmendjen dhe përkrahjen e faktorit ndërkombëtar, e që pasoi edhe me bombardimet e Aleancës Veriatlantike mbi caqet e forcave militare dhe e paramilitare të armikut serbo sllav, e që rezultoi me largimin përfundimtar të tyre nga Kosova.

Sot Kosova falë asaj lufte dhe sakrifice mbarëkombëtare, frymon lirshëm, është e pavarur dhe ka krijuar institucione kredibile të përkushtuara për të punuar në integrimin dhe zhvillimin e Kosovës. Kjo frymë lirie fatkeqësisht edhe pas 26 viteve të çlirimit të Kosovës, nuk u ndie e s'po ndjehet nga shumë luftëtarë lirie, të cilët që nga paslufta e edhe sot po përballën me akuza të pabaza të fabrikuara. Sot prijësit e luftës dhe të shtetit tonë, vazhdojnë sakrificën akoma me organet e drejtësisë ndërkombëtare, në mbrojtje të luftës sonë të drejtë, e që jemi të bindur së shpejti do të kthehen triumfues si çdo herë.

Në institucionet lokale dhe qendrore duke ndjerë gjithherë në shpirt luftën dhe sakrificën e popullit tonë për liri, të angazhohemi fort, në partneritet të palëkundur me aleatët tanë, që të punojmë me përkushtim për të zhvilluar dhe integruar vendin tonë.  
Lavdi e përjetshme komandantit Adem Jashari dhe të gjithë të rënëve për lirinë e Kosovës!

## **2. Fjalimi i Kryetarit të Komunës, Besim Ilazi**

I nderuar Kryesues i Kuvendit Komunal, të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, të nderuara familje të dëshmorëve, përfaqësues të OVL-së së UÇK-së, përfaqësues nga OSBE-ja dhe ju mysafir të tjerë të pranishëm

Muaji mars na kujton sakrificën, dhe qëndresën e popullit tonë. Ndërsa ditët 5, dhe 6 dhe 7 Marsi janë ditët e krenarisë sonë mbarë kombëtare dhe përkujtimit të luftës së shenjtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të prirë nga Komandant Adem Jashari. Po sot kujtojmë heroizmin e pa shoq të familjes Jashari e cila u bë akt themeltar për lirinë e atdheut, duke u bërë një rast i veçantë kudo nëpër botë, një familje e bashkuar stoike, e për tu bërë më vonë monument përjetësie deri sa të ketë jetë në këtë tokë.

Për tri ditë radhazi, në Kullat e Jasharajve, në këto kulla të qëndresës, kjo familje u bëri ballë sulmeve të fuqishme, ku burra, gra e fëmijë, luftuan e kënduan deri në frymën e fundit, me një qëllim e ideal të përbashkët.

Epopetë janë ngjarje heroike të rëndësishme për një popull, e ku do të kishte emërtim më të skalitur se sa Epopeja e Ushtrisë Çlirimtare e Kosovës, sepse pikërisht ditët e Marsit, janë ditët që sollën lulet e para të pranverës së vonshme të asaj kohe. Krismat e Prekazit heroik, u bënë frymëzim për shumë djem e vajza anë e kënd Kosovës, duke u bërë kushtrimi dhe jehona për mbrojtjen e atdheut.

Të nderuar të pranishëm

Në këtë ditë të shënuar e të rëndësishme për secilin nga ne, kujtojmë sakrificën sublime të dëshmorëve, martirëve, ushtarëve e eprorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kujtojmë sot sakrificën edhe për qindra e mijëra djem e vasha të anës së Kaçanikut që tashmë ishin rreshtuar në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, nën udhëheqjen madhështore të dy Komandantëve Agim Bajrami e Qamil Ilazi.

Janë mbi dy dekada që nga ajo ngjarje, por sado që koha kalon, Epopeja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, do të jetë monumenti më i mirë i përjetësisë dhe madhështia dhe kauza e vet popullit tonë, me vite e shekuj për liri e pavarësi të vendit tonë.

Duke ndërtuar të tashmen dhe të ardhmen tonë, asnjëherë e asnjë ditë nuk duhet harruar të nderojmë të gjithë heronjtë, dëshmorët dhe martirët, të cilët nuk kursyen jetën për të realizuar një ëndërr që është bartur tek ne brez pas brezi – Lirinë!

Lavdi e përjetshme për ju që nuk kursyet asgjë nga vetja që ne sot të frymojmë lirë.

Ju faleminderit!

## **3. Fjalimi i përfaqësuesve të grupeve parlamentare të Kuvendit të Komunës**

Në këtë pikën, nga PDK fjalën e mori, anëtari i KK Rustem Zenuni, -shef i grupit të PDK, ndërkaq nga LDK, fjalën e mori anëtarja e KK, Ardita Rrahmani-shefe e grupit të LDK.

### **Fjalimi i përfaqësuesit të grupit të PDK të përfaqësuar në KK, Rrustem Zenuni**

Të nderuar të pranishëm, familjarë të dëshmorëve, invalid e veteranë të UÇK-së, të dashur qytetarë të Kaçanikut.

Sot jemi mbledhur për të nderuar një nga kapitujt më të lavdishëm të historisë sonë kombëtare-Epopenë e UÇK-së, të zhvilluar më 5, 6 dhe 7 mars të vitit 1998. Këto tri ditë nuk janë thjesht data në kalendar, por janë simbol i qëndresës, guximit dhe sakrificës sublime për lirinë e Kosovës.

Në këto ditë, në Prekaz, në zemër të Drenicës, komandanti legjendar Adem Jashari, familja e tij dhe bashkëluftëtarët e UÇK-së shkruan me gjak një histori të paharrueshme. Përballë një armiku të pamëshirshëm që nuk kursyen fëmijë, gra e as te moshuarit, por ata luftuan, nuk u dorëzuan, nuk u zmbrapsën, por qëndruan deri në frymën e fundit, duke dëshmuar se liria nuk dhurohet, por fitohet me sakrificë.

Familja Jashari nuk luftoi vetëm për vete, por për të gjithë shqiptarët, për të ardhmen e Kosovës, për një të ardhme pa shtypje e pa dhunë. Ata u bënë pishtarë të lirisë dhe frymëzim për gjithë kombin. Nga ai moment, UÇK-ja mori hov dhe populli shqiptar u ngrit në këmbë për të çliruar atdheun.

Sot, ne, si breza të lirë, kemi përgjegjësinë të mos harrojmë kurrë këtë sakrificë. Liria që gëzojmë sot ka emra dhe mbiemra. Ka histori të shkruara me gjak. Prandaj, le të angazhohemi për një Kosovë të fortë, të bashkuar dhe të zhvilluar, ashtu siç e dëshën dëshmorët tanë.

Ne sot nuk e përkujtojmë Epopenë e UÇK-së vetëm si një ngjarje historike, por përkujtojmë edhe si një amanet të shenjtë që na obligon të punojmë për një Kosovë të drejtë, të lirë dhe të zhvilluar. Sakrifika e familjes Jashari dhe e mijëra dëshmorëve të tjerë nuk ishte vetëm një akt heroizmi, por një thirrje për të gjithë ne që të vazhdojmë rrugën e ndërtimit të shtetit tonë me përkushtim, dinjitet dhe ndershmëri.

Sot, kur Kosova është shtet i pavarur dhe sovran, ne duhet të kujtojmë se liria dhe pavarësia duhen ruajtur, forcuar dhe mbrojtur me punë të ndershme, me drejtësi, me unitet dhe me përkushtim ndaj interesave kombëtare.

Le të kujtojmë gjithmonë se për çfarë u derdh gjaku i dëshmorëve tanë! Ata nuk ranë që ne të ndahemi e të përçahemi. Nuk ranë që korrupsioni dhe padrejtësia të minojnë themelet e shtetit për të cilin luftuan. Ata dhanë jetën që ne të jetojmë me dinjitet, të edukojmë brezat e rinj me ndjenjën e përgjegjësisë për atdheun dhe të ndërtojmë një Kosovë ku sundon ligji, drejtësia dhe mirëqenia për të gjithë. Andaj, sot dhe përherë, le të mbajmë të gjallë idealin e atyre që luftuan për ne. Le të punojmë çdo ditë për një Kosovë të fortë, të sigurt dhe të integruar në botën demokratike, sepse vetëm kështu e nderojmë vërtet Epopenë e UÇK-së.

Lavdi përjetë Dëshmorëve të Kombit!

Lavdi Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës!

Rroftë Kosova e lirë dhe sovranë!

### **Fjalimi i përfaqësuesit të grupit të LDK të përfaqësuar në KK, Ardita Rrahmani**

I nderuar kryetar, nënkryetar, kryesues, përfaqësues të organizatave të dala nga lufta, familje dëshmorësh, veteran, kolege asamblistë, qytetare të Kaçanikut me lejoni që në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës dega në Kaçanik të uroj çdo qytetare të këtij vendi për shënimin e 26 të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Çdo vit ne këtë ditë ne përkujtojmë sakrificën sublime të të gjithë atyre që dhanë jetën për

lirinë.

Muaji Mars i vitit 98, asokohe botës se qytetëruar e moderuar ja tërhoqi vëmendjen duke u bërë dëshmi e gjallë e krimit që veç kishte të ndezur kandilat nga okupatori.

Marsi I 98-tës mbetet muaji i lavdisë tone kombëtare, muaj i rezistencës, muaj i sakrificës e muaj i flijimit.

Marsi i 98tes në gjithë Republikën e Kosovës, munda friken, e i hapi shtigjet e lirisë dhe te ardhmërisë.

Prandaj jo rastësisht sot Prekazi – Lagjja e Jasharëve është dhe do te mbetet përherë pikënisja jonë, referenca e jonë e kurorëzimit të lirisë.

Ardhjen tonë në jetë, nuk e përcaktojmë asnjëri nga ne, por zgjedhjen e të jetuarit ndershëm dhe punuarit ndershëm e kemi vet ne dorë, e zgjedhjen për të e mbyll një cikël jete, po për te ngjallë një fije shprese në një popull të persekutuar, shpresë mbi jetën dhe lirinë e dëshmoi edhe komandanti legjendar Adem Jashari bashke me familjen e tij mbi 50 anëtarësh të rënë në sulmin e tretë dhe fatal ndaj tyre mes natës se 4-5 Marsit 98. Askush nuk jeton përgjithmonë, por dikujt emri i gdhendet në histori, e në historinë modern të kësaj Republike është, emri i Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe i Ushtrisë Çlirimtare të Kosoves.

#### **4. Fjalimi i përfaqësuesit të shoqatave të dala nga lufta e Ushtria Çlirimtare e Kosovës-UÇK-së, Xhabir Elezi**

Të nderur anëtarë të Kuvendit të Komunës së Kaçanikut, i përshëndes Kryetarin e Komunës, Besim Ilazin, Kryesuesin e Kuvendit të Komunës, Kemal Murseli.

Marsi i lavdisë dhe krenarisë kombëtare, Prekazi i 5,6 dhe 7 Marsit të Vitit 1988.

Familja Jashari në krye me komandantin legjendar Adem Jashari, mbetën shembull unik i qëndresës dhe rezistencës, simbol i vendosmërisë dhe sakrificës, heroizmit dhe atdhedashurisë, ndryshimit të epokave, dhe krenarisë kombëtare, bazamenti i lirisë së Kosovës.

Këtë kushtrim e vazhdoj me krenari të lartë edhe Brigada 162 Agim Bajrami nën drejtimin e Agim Bajramit dhe Qamil Ilazit.

Lavdi familjes Jashari!

Lavdi të gjithë dëshmorëve dhe martirëve të rënë!

Ju faleminderit!

**Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli**, i falënderoj pjesëmarrësit e këtij takimi, ndërkaq theksoj se jemi në fund të mbledhjes sipas agjendës, duke iu uruar të gjithë besimtarëve mysliman dhe juve anëtarë të nderuar, muajin e shenjë të ramazanit, e shpalli të përfunduar mbledhjen solemne të KK. Ora e përfundimit të mbledhjes, 10:25.

Procesmbajtës  
Makfire Malsiu

*Makfire Malsiu*

